



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 247/11 Prot.

Tiranë, më 02/02/2024

VENDIM

Nr. 05, datë 02.02.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIME NË STRUKTURËN E
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
ELEKTRIKE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa ç, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, germa c, në Udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” në propozimin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike me Nr. 352 Prot., datë 06.09.2023, “Relacion mbi propozimin për ndryshime në strukturën e FIE”, në Vendimin e Bordit të Administrimit të UPT Nr. 16, datë 17.07.2023, “Për miratimin e niveleve, klasave dhe grupeve të pozicioneve të punës, si dhe miratimin e strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të personelit administrativ dhe ndihmësakademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”, në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike Nr. 247 Prot., datë 01.02.2024 të Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.02.2024,

VENDOSI:

Të miratojë propozimin që Përgjegjësi i Qendrës Multimediale të emërtohet Kryetar Dege në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

